

VENDIM
“Për Lejimin e Sekuestrimit të të dhënave Kompjuterike”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë prej :

NERITAN CENA – GJYQTAR

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Besa Lleshi**, sot në Tiranë më datë 08.06.2013, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike çështjen penale me Nr.Regj.Them që i përket :

KËRKUES : Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përfaqësuar nga prokuror Antoneta Sevdari

OBJEKTI :

1. Lejimin e Sekuestrimit të të dhënave kompjuterike në sistemin kompjuterik të Intesa San Paolo Bank me qëllim marrjen e të dhënave që ndodhen në këtë sistem dhe që kanë të bëjnë me transaksionet e kryera në “POS” e subjektit “One travel” me kartat e “Capital One Bank”
2. Lejimin e Sekuestrimit të të dhënave kompjuterike në sistemin kompjuterik të “Raiffeisen Bank” me qëllim marrjen e të dhënave që ndodhen në këtë sistem dhe që kanë të bëjnë me transaksionet e kryera në “POS” e subjektit “One travel” me kartat e “Capital One Bank”

BAZA LIGJORE : Neni 208/a të K.Pr.Penale

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, përfaqësuesja e palës kërkuese, prokurore Antoneta Sevdari kërkoi :

- Pranimin e kërkesës

Gjykata pasi dëgjoi pretendimet e përfaqësueses të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Prokurore Antoneta Sevdari, shqyrtoi provat shkresore që ndodhen në dosje, s’i dhe pasi e diskutoi çështjen në tërësi.

VËREN

Se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton t’i jetë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë me anë të së cilës në zbatim të nenit 208/a të K.Pr.Penale ka kërkuar :

I. Lejimin e Sekuestrimit të të dhënave kompjuterike në sistemin kompjuterik të Intesa San Paolo Bank me qëllim marrjen e të dhënave që ndodhen në këtë sistem dhe që kanë të bëjnë me transaksionet e kryera në “POS” e subjektit “One travel” me kartat e “Capital One Bank”

II. Lejimin e Sekuestrimit të të dhënave kompjuterike në sistemin e “Raiffeisen Bank” me qëllim marrjen e të dhënave që ndodhen në këtë sistem dhe që kanë të bëjnë me transaksionet e kryera në “POS” e subjektit “One travel” me kartat e “Capital One Bank”

Nga aktet që ndodhen në dosje bashkangjitur kërkesës rezulton se :

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar çështjen penale nr. 2801, datë 24.05.2013 për veprën penale të “Mashttrimit kompjuterik” të kryer në dëm të shumë personave të parashikuar nga neni 143/b/2 të Kodit Penal për shkak se më datën 24.05.2013 seksioni i krimit kompjuterik në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë është njoftuar nga punonjës të bankës “Intesa Sanpaolo” se pranë subjektit tregtar të quajtur “One Travel” janë kryer disa transaksione bankare të dyshuara s’i të paligjshme nëpërmjet përdorimit të kartave bankare të cilat dyshohen të falsifikuara nga persona të pidentifikuar.

Më datën 23.05.2013 në aparaturnë POS të vendosur nga banka “Intesa SanPaolo” në këtë subjekt tregtar janë konstatuar rreth 10 transaksione të dyshuara të paligjshme nëpërmjet përdorimit të pesë kartave bankare të lëshuara nga banka të ndryshme amerikane.

Disa prej këtyre transaksioneve kanë qenë të sukseshme dhe nëpërmjet përdorimit janë procesuar për të kaluar në llogarinë e këtij subjekti tregtar shuma rreth (.....) Nga informacionet ka rezultuar se administrator i subjektit “One Travel” është shtetas i Juventus Cere dhe shuma e parave të procesuara është bllokuar nga banka për arsye të verifikimit të procesit të kryera nga ky subjekt. Administratori i shoqërisë “One Travel” rezulton të jetë paraqitur në zyrat e bankës “Intesa Sanpaolo” dhe ka dhënë shpjegime lidhur me arsyen e përdorimit të këtyre kartave shpjegime të cilat nuk kanë qenë të besueshme.

Nga informacioni i mëtejshëm i marrë nga “Intesa Sanpaolo Bank” rezulton se veprimet e kryera në POS – in e subjektit “One travel” nuk janë kryer nga kartëmbajtësi pra janë veprime mashtruese.

Gjatë hetimit të këtij procedimi penal është dërguar informacion nga Raiffeissen Bank nga i cili rezulton se në aparatën POS që i përket subjektit tregtar “One Travel” janë kryer 11 transaksione me karta të lëshuara nga banka amerikane “Capital One”.

Nga 11 transaksionet e kryera 7 prej tyre kanë qenë të sukseshme në shumat (.....) euro dhe administratori Juventus Cere ka justifikuar transaksionin me dy bileta avioni të konfirmuara për dy persona më konkretisht (.....) dhe (.....). Nga informacioni i dërguar nga Raiffeissen Bank rezulton se në rastin konkret duke analizuar numrin e veprimeve të kryera, volumin e transaksioneve shumat e përdorura rezulton se jemi para rasteve të mashtrimeve kompjuterike me karta krediti të klonuara.

Nga kqyrja e sistemit Tims rezulton se shtetasit (.....), (.....), (.....), (.....) nuk kanë hyrje dalje nga Territorit i Republikës së Shqipërisë në data që paraqiten në rezervimet e biletave.

Për shkakun e sipërcituar nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vlerësuar që të kqyren pranë bankave “Intesa San Paolo Bank” dhe “Raiffeisen Bank” sistemi kompjuterik me qëllim marrjen e të dhënave që ndodhen në këtë sistem dhe që kanë të bëjnë me transaksione të kryera në “POS” e subjektit “One travel” me kartat e Bankës Amerikane “Capital One Bank”.

Nisur nga sa u parashtrua më lart nga ana e gjykatës vlerësohet se kërkesa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në zbatim të nenit 208/a të K.Pr.Penale duhet pranuar si e bazuar në prova dhe në ligj.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata në zbatim të nenit 208/a të K.Pr.Penale

VENDOSI

- Pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë
- I.** Lejimin e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike në sistemin e shoqërisë “Intesa San Paolo Bank” sh.a me qëllim marrjen e të dhënave që ndodhen në këtë sistem dhe që kanë të bëjnë me transaksionet e kryera në “POS” e subjektit “One travel” me kartat e “Capital One Bank”.
- II.** Lejimin e Sekuestrimit të të dhënave kompjuterike në sistemin e shoqërisë “Raiffeisen Bank” sh.a me qëllim marrjen e të dhënave që ndodhen në këtë sistem dhe që kanë të bëjnë me transaksionet e kryera në “POS” e subjektit “One travel” me kartat e “Capital One Bank”.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë sipas afateve ligjore.
- U shpall në Tiranë sot më datë 08.06.2013.

SEKRETARE

BESA LLESHI

GJYQTAR

NERITAN CENA